

**Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo**  
*Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës*  
*Kancelarija Specijalnog Tužilaštva Republike Kosovo*

Prishtinë, 5 gusht 2010

GjPP no. 65/09

PPS No: 08/09

**Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë**

Në pajtim me nenet 304-305 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Prokurori i poshtë nënshkruar me respekt e paraqet këtë:

**AKTAKUZË**

**Kundër:**

**Sabit Gecit**, Shqiptar Kosovar, Mashkull, me ditëlindje 20 gusht 1958, vendlindja fshati Llaushë Komuna e Skenderajt, me vendbanim në rr. Mbreti Zogu nr. 9 në Prishtinë, momentalisht i mbajtur në Qendrën Regjionale të Paraburgimit në Prishtinë që nga 6 maji 2010 dhe

**Riza Alija** (“Komandant Hoxhaj”), mashkull kosovar shqiptar, ditëlindja 21 janar 1960; vendlindja Gjakovë, që banon në fshatin Ponoshec komuna e Gjakovës, momentalisht mbahet në paraburgim me urdhër të gjykatës që nga 23 qershori 2010.

Të dy të pandehurit e mësipërm<sup>1</sup> përmes kësaj janë të akuzuar se kanë kryer **Krime lufte kundër popullatës civile** që në mënyrë më të plotë është paraqitur si më poshtë:

**Përshkrimi i veprave penale dhe shpjegimi i bazave për ngritjen e aktakuzës (Neni 305 (1) 3), 4), 5) i KPPK)**

Gjatë konfliktit në Kosovë gjatë vitit 1998-1999 shumë persona u larguan nga Kosova dhe shkuan si refugjatë diku tjetër. Shumë kosovarë shqiptarë kërkuan siguri në Shqipëri. Një numër i personave që shkuan si refugjatë në Shqipëri ishin takuar dhe ishin marrë në pyetje nga agjentët dhe nga zyrtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Disa prej këtyre civilëve ishin marrë dhe ishin mbajtur në paraburgim për periudha të ndryshme kohore.

<sup>1</sup> I dyshimti i tretë **Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR]**; mashkull kosovar shqiptar, datëlindja 12 dhjetor 1963, vendlindja fshati Leskovec, komuna e Prizrenit, momentalisht në arrati, dhe prandaj nuk është i akuzuar me këtë aktakuzë. Për hir të qartësisë, emri i **Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR]** do të shfaqet gjatë shpjegimeve faktike duke kuptuar se ai nuk është i akuzuar me këtë aktakuzë dhe referencat i bëhen atij vetëm me qëllim të paraqitjes së saktë.

Nga fundi i marsit ose fillimi i prillit 1999 dhe duke vazhduar deri në mes të qershorit 1999 UÇK-ja kishte krijuar dhe kishte vënë në funksion disa baza logjistike, trajnuese dhe furnizuese në Shqipërinë veriore. Dy prej këtyre bazave ishin vendosur në qytetin e Kukësit dhe Cahanit.

Në këto dy lokacione disa persona të caktuar të UÇK-së paraburgosën civilë dhe persona që nuk merrnin pjesë në luftë për arsye të ndryshme. Disa të paraburgosur ishin të dyshuar se bashkëpunonin me qeverinë serbe. Të tjerët kishin bindje të ndryshme politike që nuk përputheshin me bindjet e anëtarëve të caktuar të UÇK-së. Të tjerët nuk tregonin besnikëri të duhur ndaj kauzës së UÇK-së. Në bazat e Kukësit dhe të Cahanit disa individë të caktuar të UÇK-së rregullisht i keqtrajtonin civilë të caktuar të paraburgosur për një kohë të caktuar, veçanërisht në mes të prillit dhe mesit të qershorit 1999. Të tre të dyshimtit e identifikuar dhe të shenjestrar në këtë rast ishin të përfshirë drejtpërdrejt në urdhërimin dhe pjesëmarrjen në keqtrajtim të personave që mbaheshin në këto baza paraburgimi<sup>2</sup>. Përveç kësaj të burgosurit mbaheshin në kushte çnjerëzore dhe rriheshin dhe torturoheshin nga të pandehurit dhe disa individë të tjerë me emra ose pa emra të UÇK-së. Dëshmitarët dëshmuuan se ata pësuan lëndime të rënda trupore dhe vuajtje të mëdha, fizike dhe mendore, për shkak të kushteve në të cilat mbaheshin dhe si rezultat i rrahjeve dhe torturave ndaj tyre. Një person i paraburgosur në Kukës vdiq si rezultat i rrahjeve dhe torturave që i ishin shkaktuar atij.

Kur më 6 maj 2010 Sabit Geci ishte arrestuar në Prishtinë, Kosovë, për akuza të krimeve të luftës, ai e posedonte një armë zjarri.

### Sabit Geci

- 1) Krimet e Luftës Kundër Popullates Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikës Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkrimuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundërshtim te **Nenit 3 i perbashkët** me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te datës 8 Qershor 1977, plotësim i Konventës se Gjenevës te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anëtarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne nje burg te improvizuar te vendosur brenda bazës ne qytetin e Kukësit, (burgu i Kukesit), dhe bashkarisht me Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] dhe pjesetaret e tjere te UÇK-se, i **trajtoi ne menyre ç'njerezore** (si p.sh, kushte te felliqta per jete, mungese te nyjes se duhur sanitare, ushqimit dhe ujit), nje numer te pacaktuar te te burgosurve civil, duke perfshire deshmitarin H, deshmitarin A, deshmitarin B, A [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR], deshmitarin C, deshmitarin D, deshmitarin E dhe deshmitarin F;

- **Ne Kukes (Republika e Shqipërisë) nga Prilli 1999 deri ne mes te Qershorit 1999.**

---

<sup>2</sup> Nga dëshmitë , duket që i pandehuri Sabit Geci dhe Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] kishin qasje dhe disa masa të kontrollit ndaj personave që mbaheshin në Kukës dhe në Cahan. I pandehuri Riza Alija kishte qasje ndaj personave që mbaheshin vetëm në Cahan

2) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundershtim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithe kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne burgun e Kukesit, ne bashkepunim me Xh [REDACTED] K [REDACTED] dhe anetaret e tjere te UÇK-se, torturoi deshmitarin H, deshmitarin A, deshmitarin B, A [REDACTED] B [REDACTED], deshmitarin C, deshmitarin D, deshmitarin E dhe deshmitarin F, te gjitha keta te burgosur civil , ne perpjekje qe te sigurojne informata dhe rrefim nga viktimat duke perodre vazhdimisht dhune kunder tyre duke i urrdheruar ushtaret e tjere te UÇK-se te veprojne njesoj;

- **Ne Kukes (Republika e Shqiperise) me ose rreth dates 19 Maj 1999**

3) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundershtim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithe kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne burgun e Kukesit, ne bashkepunim me Xh [REDACTED] K [REDACTED] dhe anetaret e tjere te UÇK-se, ne disa raste ka **shkelur me dhune integritetin trupor** te nje numri te te burgosurve (me teper se 10, duke eprfshi deshmitaret si ne vijim, deshmitarin H, deshmitarin A, deshmitarin B, Anton Bisakun, deshmitarin C, deshmitarin D, deshmitarin E dhe deshmitarin F) nepermjet keqtrajttimeve dhe rrahjeve brenda qelise se improvizuar ku te burgourit e ketille mbaheshin te mbyllur.

- **Ne Kukes (Republika e Shqiperise) data e pacaktuar, ne mes te Prillit te 1999 dhe Qershorit te 1999**

4) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundershtim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithe kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne burgun e Kukesit Duke e mbajtur një pozicion komandues në burgun e kukësit, në bashkëpunim me Xh [REDACTED] K [REDACTED] dhe anëtarët tjerë të UÇK-ës morën pjesë në **vrasjen** e A [REDACTED]

B■■■■, një civil i mbajtur rob në Kukës, I cili vdiq si rezultat i një të plage në këmbë nga e shtënat me armë të shkakuar nga një e shtëne nga një ushtar deri më tani i paidentifikuar i UÇK-ës; më saktësisht, i pandehuri ka marr pjesë në vrasje duke e mbajtur A■■■■ B■■■■ të burgosur në dispozicion të tij dhe kryesëve të tjerë të përfshirë për torturim, rrahje dhe çfarëdo lloj keqtrajtimi, edhe pse ai e ishte ne dijeni ose lehtë mund të parashihte se një dhunë sistematike që po e ushtronte ai dhe kryerit e tjerë për çdo ditë ndaj të burgosurve mund të rezultonte me vdekjen e një ose më tepër viktimave;

- **Në Kukës (Republika e Shqipërisë) më ose rreth 5 Qershorit 1999**

- 5) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundërshtim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne burgun e Kukesit në bashkëpunim me Riza Alija **ka cenuar integritetin trupor** të Dëshmitarit L, një cvivil i burgosur në një burg të improvizuar të vendosur brenda kompleksit ushtarak të UÇK-ës në qytetin e Cahanit (“Burgu i Cahanit), duke e rrahur mizorisht në mënyrë të vazhdueshme me një paterice dhe një shkop druri;

- **Në Cahan (Republika e Shqipërisë) më ose rreth 12 Prillit 1999,**

- 6) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundërshtim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) duke mbajte postin komandues ne burgun e Kukesit në bashkëpunim me Riza Alija **ka cenuar integritetin trupor** të një numri të papërcaktuar të civilëve, duke përfshirë Dëshmitarin L, Dëshmitarin O, Dëshmitarin K, Dëshmitarin M dhe Dëshmitarin N, të burgosur në burgun e Cahanit, duke urdhëruar kryesin e drejtëpërdrejtë Riza Alija që të përdorë dhunën kundër tyre;

- **Në Cahan (Republika e Shqipërisë) në data të padefinuara në mes të 12 prillit dhe mesit të qershorit 1999.**

### Riza Alija

- 1) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundërshtim te **Nenit 3 i perbashket** me

Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) Së bashku me tani për tani anëtarë të pa definuar të UÇK-së, **trajtuar jo njerëzisht** ( p.sh. kushte të pista për jetesë, mungesë adekuate sanitare, ushqimi,dhe uji) një numër të pa definuar të të burgosurve civil,të mbajtur në arrest në burg në Cahan;

- 2) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundershkrim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK) në bashkëveprim me Sabit Gecin **ka cenuar integritetin/tërësinë/ truporë** të dëshmitarit L, një civil i mbajtur në arrest në një burg të improvizuar i vendosur brenda bazës ushtarake të UÇK-së në qytetin Cahan( Burgu Cahan), të cilin e kanë rrahur rregullisht dhe ashpër me shkop të drurit dhe me patericë ;
- 3) **Krimet e Luftes Kunder Popullates Civile**, e denueshme sipas Nenit 22 dhe 142 te Kodit Penal te Republikes Federale te Jugosllavise, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 te Kodit Penal te Kosoves sepse ne kundershkrim te **Nenit 3 i perbashket** me Konventen e Katert te Gjeneves, te dates 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) te Protokollit II** te dates 8 Qershor 1977, plotesim i Konventes se Gjeneves te vitit 1949, te gjitha rregullat e ligjit nderkombetar ne fuqi kohen e konfliktit te armatosur ne Kosove dhe gjithë kohen relevante per kohen akuatle, **i pandehuri**, ne cilesine e anetarit te Ushtrise Çlirimtare te Kosoves (UÇK)në bashkëveprim me Sabit Gecin dhe anëtarë të tjerë të pa definuar të UÇK-së , duke i vepruar nën urdhërat e Sabit Gecit, **ka cenuar integritetin/tërësinë/ truporë** të civilëve në vijim të mbajtur në arrest në burgun e Cahan-it:
  - a. Dëshmitari L, duke e rrahur atë në disa mënyra, duke përfshirë të goditurit me këpucë të rëndë për punë, **me apo rreth 14/04/1999**: dhe duke urdhëruar ushtarët e UÇK-së deri më tani të pa identifikuar që ta godasin dhe shqelmojnë dëshmitarin L në disa raste ( sidomos kur ky i fundit ishte mbyllur nga qelia në tualet), **në datat e pa specifikuar në mes të 12/ 04/1999 dhe në mes të qershorit 1999**.
  - b. Dëshmitarin M duke e goditur vazhdimisht në shpinë me shufër hekuri , **me ose rreth 17/04/1999**.
  - c. dëshmitari O, dëshmitari K, dëshmitari M dëshmitari N, dhe duke urdhëruar të tjerët ushtarë të UÇK-së deri më tani të pa identifikuar që ti rrahin ata, me **Në datat e pa specifikuar në mes të 12/ 04/1999 dhe në mes të qershorit 1999**.

### ***Posedimi i paautorizuar i armëve (Sabit Geci)***

Më 6 maj 2010, derisa po arrestohej për akuza të krimeve të luftës të përshkuara këtu, Sabit Geci ka pasur në posedim personal një armë, një revole gjysmë automatike, më saktësisht, një Crvena Zastava M-57 Lux i kalibrit 7.62x25 mm. Kjo ishte një armë

plotësisht funksionale dhe e mbushur kurse ai posedonte këtë armë në mënyrë të paautorizuar. Më 10 qershor 2010 gjatë dëgjimit, Sabit Geci, në praninë e avokatit të tij ka pranuar se ka poseduar armë. Komenti i tij erdhi si përgjigje kur prokurori po e këshillonte atë se hetimet kundër tij kishin të ngjarë të përfshinin edhe akuzat për armë. Posedimi i paautorizuar nga ana e tij e një arme më 6 maj 2010 përbën një shkelje të nenit 328(2) të KPK që parasheh një gjobë deri 7.500 Euro apo burg nga një deri tetë vite.

### ***Konsideratat tjera:***

1. Veprimet e të pandehurve kanë ndodhur gjatë një periudhe kohore kur në Kosovë ekzistonte një konflikt i brendshëm i armatosur. Në lidhje me veprat që kanë ndodhur gjatë periudhës përafërsisht prill 1999 deri 12 qershor 1999, këto kanë ndodhur kur në Kosovë ekzistonte një gjendje e konfliktit të brendshëm të armatosur. Gjatë tërë kohës relevante për këtë aktakuzë, ekziston një gjendje e konfliktit të brendshëm të armatosur ndërmjet UÇK-së dhe Republikës Federative të Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë, përfshirë Armatën Jugosllave (VJ), forcat e Republikës Federative të Jugosllavisë (FRY) Ministrisë së Brendshme, forcave të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë dhe ushtarëve paramilitarë serbë në territorin e Kosovës. Të dy forcat e armatosura ishin nën komandën përgjegjëse të cilat ushtronin kontroll mbi pjesë të territorit të Kosovës, për t'iu mundësuar të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të organizuara. Një konflikt ndërkombëtar i armatosur ka bashkë-ekzistuar me konfliktin e brendshëm të armatosur gjatë periudhës 24 mars 1999 deri 12 qershor 1999<sup>3</sup>.
2. Sjellja e cekur në nenin 142 të KPRSFJ-së dhe siç ceket në këtë aktakuzë përbën krime lufte pasi që secili veprim kyç i identifikuar shkelje të ligjit të aplikueshëm ndërkombëtar, përfshirë Nenin 3 të Përbashkët për katër Konventat e Gjenevës së vitin 1949, të aplikueshme në konflikt të brendshëm të armatosur; Konventat e Hagës së vitin 1899 dhe 1907, katër Konventat e Gjenevës së vitit 1949, dhe Protokolin Shtesë II të vitit 1977 të Konventës së Gjenevës së vitit 1949, të aplikueshme në një konflikt të brendshëm të armatosur<sup>4</sup>.

---

<sup>3</sup> Se në Kosovë ka pasur një konflikt të brendshëm të armatosur gjatë 1999 deri nga mesi i qershorit 1999 dokumentohet nga literatura bashkëkohore dhe gjykatat e mirënjohura. Konflikti i armatosur ndërmjet NATO-s dhe RFJ-së përbënte një konflikt të armatosur ndërkombëtar. Kishte filluar më 24 mars 1999 me fillimin e kampanjës së bombardimeve të NATO-s dhe kishte zgjatur deri më 12 qershor 1999, kur forcat e RFJ-së u tërhoqën nga Kosova pas përfundimit të kampanjës ajrore të NATO-s. Shih Tadic, Vendimi i Dhomës së Apelit mbi Juridiksionin 1995, par 84 i cili thekson: “*Është e padiskutueshme që një konflikt i armatosur është ndërkombëtar nëse ndodh në mes të dy apo më shumë shteteve. Po ashtu, në rastet e konfliktit të brendshëm të armatosur i cili shpërthen në territorin e një shteti, mund të bëhet ndërkombëtar (ose, në varësi të rrethanave, të bëhet me karakter ndërkombëtar gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur) nëse i) një shtet tjetër intervenon në atë konflikt përmes trupave të tij, apo nëse ii) disa nga pjesëmarrësit në konfliktin e armatosur të brendshëm veprojnë në emër të një shteti tjetër.*” Po ashtu shih Gjykata Supreme e Kosovës – Latif Gashi et al, AP-KZ 1 39/2004 faqe 10-11 (“*Qartazi në Kosovë ka qenë një konflikt i brendshëm in armatosur brenda kuptimit të nenit 3 të Përbashkët për Konventën e Gjenevës dhe Protokollit të saj shtesë II*)

<sup>4</sup> Shih Gjykata Supreme e Kosovës – Latif Gashi, et.al, AP-Kz 39/2004, faqe 4-8

3. Neni 142 i KPRSFJ-së është ligji i aplikueshëm në Kosovë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, që thekson se ligji i aplikueshëm në Kosovë është ai i cili ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Konform kërkesave të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së vitit 1974, neni 181, pjesë i ligjit të aplikueshëm në Kosovë, (që veprat penal dhe sanksionet penale mund të bazohen vetëm në një dispozitë ligjore që definojnë veprën dhe kërcënojnë një dënim), neni 142 i KPRSFJ definojnë veprën e krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe përcaktojnë aty edhe dënimin përkatës.
4. Të gjitha viktimat e krimeve të luftës të referuara në akuza të kësaj aktakuze janë pjesëtarë të mbrojtur të popullatës civile, siç përcaktohet në nenin 142 të KPRSFJ-së dhe në bazë të ligjit ndërkombëtar të përmendur më lart.
5. Ekziston një lidhje ndërmjet krimeve të kryera të luftës, siç cekën në këtë aktakuzë dhe konfliktit të brendshëm të armatosur. Ekzistimi i konfliktit të armatosur ka luajtur një pjesë substanciale në alibinë e të pandehurve për të kryer veprat penale si dhe veprimet e të pandehurve drejtpërsëdrejti ishin të lidhur me konfliktin e armatosur.
6. Edhe pse veprimet e supozuara kanë ndodhur në Shqipëri, gjykata e Kosovës kanë juridiksion mbi çdo person që ka kryer një krim lufte jashtë territorit të Kosovës. Neni 100 (1) i KPK<sup>5</sup>. Për të tepër, neni 106 i KPRSFJ thekson që “Ligji penal i Jugosllavisë vlen për një qytetar të RSFJ-së kur ai ka kryer jashtë vendit një vepër penale përpos atyre të referuara në nenin 105 të këtij ligji, nëse ai është gjetur në territorin e RSFJ-së apo është ekstraduar në RSFJ”. Është e qartë që ekziston një bazë ligjore që gjykatat e Kosovës të ndjekin penalisht krimet e supozuara të luftës të kryera gjatë konfliktit në Kosovë 1998-1999 nga persona të Kosovës të gjetur dhe arrestuar në Kosovë.

### **Propozimet për Gjykim**

(Neni 305 (1) 6 dhe 7)

7. Propozohet që gjykimi kryesor i këtij rasti të caktohet dhe mbahet ose në **Gjykatën e Qarkut në Prishtinë** apo në **Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë**. Hetimi i këtij rasti ishte iniciuar nga një Vendim i paraqitur kundër Sabit Gecit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Kjo ishte parashtruar sipas nenit 30 të KPPK, që thekson se kur vepra kryhet jashtë territorit të Kosovës, “...juridiksionin do ta ketë gjykata brenda të cilit territor i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm apo momental.” Shënimet e Regjistrisë Qendrore të kohës (të 3 korrikut 2009) tregojnë se Sabit Geci ka banuar në Komunën e

---

<sup>5</sup> “Ligjet penale të Kosovës vlejnë për çdo person që kryer një vepër penale nga nenet 116-121....të Kodit aktual jashtë territorit të Kosovës.”

Skenderajit, që gjendet brenda Qarkut të Mitrovicës.<sup>6</sup> Pasi që i pandehuri Sabit Geci tani është i akuzuar për Posedim të Paautorizuar të një Arme (nenin 328 (2) i KPK). Kjo vepër është kryer në Prishtinë. Neni 31 i KPPK thekson se “nëse personi kryer vepra penale edhe në Kosovë dhe jashtë Kosovës, gjykata që ka juridiksionin mbi veprat e kryera në Kosovë do të ketë juridiksionin.” Nga kjo del se Gjykata e Qarkut në Prishtinë mund të ketë juridiksionin mbi këtë rast. Neni 32 i KPPK thekson se Gjykata Supreme mund ta caktojë gjykatën përkatëse për të kryer procedurat në rast se juridiksioni nuk mund të përcaktohet. Për prokurorinë, të dy gjykatat janë të pranueshme, mirëpo gjykata lajmërohet me këtë rast që çështja e juridiksionit kërkon zgjidhje.

8. Personat e mëposhtëm do të ftohen<sup>7</sup> që të marrin pjesë në gjykim:
  - Prokurori ndërkombëtar Maurizio Salustro nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
  - I pandehuri Sabit Geci dhe avokati i tij
  - I pandehuri Riza Alija dhe avokati i tij
  - Dëshmitarët – palët e dëmtuara: A, B, C, D, E, F, G, H, K, L, M, N, dhe O
  - Dëshmitarët – I, J dhe 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7
  - Claudio Scipione – EULEX – Njësia për hetimin e krimeve të luftës
  - Francesco Duminuco – EULEX – Njësia për hetimin krimeve të luftës
  - Victor Odom – EULEX – Njësia për hetimin krimeve të luftës
  - Joni Voutila – EULEX – Njësia për hetimin krimeve të luftës
  - Robert Castellow – EULEX – Njësia për hetimin krimeve të luftës
9. Propozohet që gjykata gjatë gjykimit të marrë parasysh dëshminë e paraqitur nga dëshmitarët, palët e dëmtuara dhe bashkëakuzuarit si dhe deklaratat e mëparshme të bëra para hetuesve dhe prokurorëve.
10. Propozohet që gjykata gjatë gjykimit të marrë parasysh provat e konfiskuara gjatë bastisjeve të vendbanimeve të tre të dyshuarve të rastit. Më 6 maj 2010, një urdhër është ekzekutuar në shtëpinë e Sabit Gecit. Gjatë arrestimit të Sabit Gecit, ishte konfiskuar një armë zjarri e cila ishte dorëzuar për ekzaminim. Shih artikulli 11 (c) më poshtë. Më 12 maj 2010, një urdhër për bastisje është ekzekutuar në shtëpinë e Xh [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR]. Më 23 qershor 2010, një urdhër për bastisje ishte ekzekutuar në shtëpinë e Riza Alija. Gjatë bastisjes, policia ka konfiskuar kompjuterë, pajisje përkatëse, libra dhe fotografi. Kompjuterët dhe disqet përkatëse dhe mjetet për ruajtje të të dhënave janë duke u

---

<sup>6</sup> Më vonë është përcaktuar që Sabit Geci po jetonte në Prishtinë. Ai ishte arrestuar jashtë shtëpisë së tij në Prishtinë më 6 maj 2010.

<sup>7</sup> Një Shtojcë Konfidenciale e veçantë i është dhënë gjykatës. Shtojca konfidenciale identifikon me emra palët e dëmtuara dhe dëshmitarët. Më 30 korrik 2010, ky prokuror ka parashtuar një kërkesë për Masa për të Mbrojtur Palët e Dëmtuara dhe Dëshmitarë të Caktuar në të cilën kërkohet që identiteti dhe informacioni lidhur me dëshmitarët të mbahet konfidencial nga ana e gjykatës dhe avokati i të pandehurit. Procedura e propozuar nga prokurori që kufizon zbulimin e identitetit të palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve është në përputhje me dhe dënohet sipas dispozitave të nenit 307 (4) të KPPK.



ekzaminuar nga ekspertët e forenzikës kurse rezultatet do ti sigurohen gjykatës kur të jenë në dispozicion.

11. Propozohet që gjykata të pranojë, shqyrtojë dhe lexojë për procesverbal këto raport forenzike:
  - a. Raporti i autopsisë – 18 gusht 2009 – A [REDACTED] B [REDACTED] – Rasti numër MA-090-216
  - b. Raporti i ADN-së – 22 dhjetor 2009 – AN KUP 11847
  - c. Raporti mbi ekzaminimin e armës së zjarrit – 16 qershor 2010-1043
  - d. Ekzaminimi forenzik i kompjuterëve dhe pajisjeve për ruajtjen e të dheneve – në pritje.
  
12. Propozohet që gjykata të pranojë, shqyrtojë kopjen e listës së emigrantëve të vdekur (refugjatëve) nga Kosova nga Mbikëqyrësi i Shërbimeve Publike i Kukësit – Komuna e Kukësit – që mbulon datat 28 mars 1999 deri 17 qershor 1999 - emri # 138 që tregon vdekjen e A [REDACTED] B [REDACTED] t nga Prizreni më 6 qershor 1999.
  
13. Ky prokuror i propozon gjykaës që të pranojë si prova këto dokumente: (1) Kosovo/Kosova as seen as Told, Volumi 1, publikuar nga OSBE; (2) Under Orders, publikuar nga Human Rights Watch; (3) Rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1160 and 1199.

**Paraburgimi**  
**(Neni 305 (2))**

Të pandehurit Sabit Geci dhe Riza Alija momentalisht gjenden në paraburgim. Prokurori kërkon me respekt që ata të mbeten në paraburgim.

Parashtruar me respekt,

5 gusht 2010

Robert L. Dean

Prokuror Publik Ndërkombëtar – EULEX  
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës